

Ligjërata 10.04.2015

Lidhja e martesës

Lidhja e martesës bëhet në mënyrë solemne kurdoherë botërisht dhe ën pranin e personave zyrtar, dhëndrit dhe nuses dhe në prani të publikut. Vendi i lidhjes së martesës nuk përcaktohet shprehimisht me dispozita ligjore, mirëpo, kjo do të thotë se bashkëshortët mund të lidhin martesën kudo që dëshirojnë në territorin e Republikës së Kosovës.

Për shkaqe të arsyeshme si sëmundja e njërit të fejuar, mbajtja e dënimit me burg etj. Bashkëshortët mund të lidhin martesë edhe në lokale tjera e jo vetëm në sallën e përcaktuar për lidhjen e martesës në nw zyren e ofiqarit tw gjendjes civile. Në aktin e lidhjes së martesës janë të detyruar të marrin pjesë dy bashkëshortët, dy dëshmitar që kanë zotësinë e veprimit dhe ofiqari i gjendjes civile.

Procedurat e lidhjes së martesës fillon me paraqitjen e raportit të gjendjes civile, vërtetimit të identitetit të bashkëshorteve, dëshmitarëve dhe me deklarimin e bashkëshorteve se nuk ka pengesa martesore për lidhjen e martesës dhe të vullnetit të lirë ku ofiqari i gjendjes civile ua lexon dispozitat ligjore.

Transkriptimi i martesës në librat amzë të ët martuarve bëhet pasi që bashkëshortët të kenë deklaruar vullnetin e lirë për lidhjen e martesës. Sipas Ligjit të familjes së Kosovës konsiderohet se martesë është lidhur në momentin e deklarimit të vullnetit të bashkëshortëve e jo në momentin e firmosjes në librat amzë të të martuarve si e parasheh Ligji i Maqedonisë.

Martesa religjioze është e lejueshme dhe mund të lidhet pas lidhjes së martesës civile, por ajo nuk prodhon efekte juridike.

Kuptimi dhe llojet e të drejtave dhe të detyrimeve të bashkëshorteve.

Me rastin e lidhjes së martesës në mes të bashkëshorteve krijohen shumë të drejta dhe detyra reciproke, si tw natyrës personale edhe pasurore. Të drejtat dhe detyrat e bashkëshorteve ndahen në të drejta dhe detyra personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje dhe në të drejta dhe detyra personale për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje.

Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët nuk mund të bëjnë marrëveshje janë të rregulluara me norma ligjore urdhëruese dhe palët nuk mund të ndryshojnë me vullnetin e tyre, por duhet ti zbatojnë ashtu si janë paraparë me dispozita ligjore. Ato janë:

- Jeta e përbashkët e bashkëshorteve
- Barazia e bashkëshorteve; pavarësia e bashkëshorteve për ta zgjedhur punën dhe profesionin;
- Detyrimi i ndihmës dhe i respektimit;
- Besnikëria bashkëshortore.

Të drejtat dhe detyrat personale për të cilat bashkëshortët mund të bëjnë marrëveshje. Këto të drejta janë të rregulluara me norma të karakterit dispozitiv që do të thotë se bashkëshortët mund ti rregullojnë me marrëveshje edhe ndryshe nga si parashihen me ligj. Ato janë:

- Caktimi i mbiemrit
- Caktimi i vendbanimit;
- Lindja e fëmijëve;
- ekonomia e përbashkët familjare
- Caktimi i shtetësisë.

Zgjidhja e martesës dhe shkaqet për zgjidhjen e martesës

Martesa mund të zgjidhet në tri mënyra:

- Me pushimin e martesës kur dy bashkëshortët ose njëri prej tyre shpallet i zhdukur si i vdekur ose vdesin;
- Me shkurorëzim zgjidhen martesat e vlefshme dhe
- Me anulim zgjidhen martesat e pavlefshme.

Me vdekjen e njërit bashkëshortë apo të dy bashkëshorteve, pushon martesa sepse ajo mund të ekzistojë vetëm sa të jenë gjallë dy bashkëshortët nga momenti i vdekjes së njërit bashkëshort të drejtën e lidhjes së martesës së re e fiton bashkëshorti që mbetet gjallë. Me shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur gjithashtu pushon martesa dhe bashkëshorti që mbetet i gjallë mund të lidh martesën e re në momentin kur akti vendimi i gjykatës bëhet i plotfuqishëm ngase shpallja e personit të zhdukur si i vdekur barazohet me vdekjen faktike.

Një person quhet i zhdukur kur mungon nga vendi i banimit dhe i qëndrimit të fundit të tij dhe për ët cilin nuk ka informata për ma shumë se dy vjet. Me kërkesën e secilit person fizik apo juridik që për një gjë të tillë ka interes juridik mund të shpallet i zhdukur me vendimin e gjykatës kompetente.

Personi që është shpallur i zhdukur me vendimin gjyqësor, me kërkesën e çdo personi të interesuar mund të shpallet i vdekur me vendim të gjykatës kur kanë kaluar pa pasur informata tri vjet nga dita që është shpallur i zhdukur, kështu sipas dispozitës së nenit 59 par 2 të Ligjit për procedurën jokontestimore, një person i zhdukur mund të shpallet si i vdekur.

- Nëse kanë kaluar 5 vjet e nuk ka pasur informata për te, kurse nga lindja e tij kanë kaluar 65 vjet;
- Nëse për jetën e tij në 5 vjet e fundit nuk dihet asgjë, kurse rrethanat me të cilat është zhdukur bëjnë të besohet se nuk është më i gjallë;
- Nëse ka humbur në fatkeqësi komunikacioni, zjarri, përmbytje, tërmeti ose ndonjë rrezik tjetër, kurse për jetën e tij nuk ka pasur kurrfarë informatash 6 muajt e fundit nga dita e heqjes së rrezikut;

- Nëse ka humbur gjatë luftës apo lidhur me veprimet luftarake, kurse për jetën e tij nuk ka pasur kurrfarë informatash 1 vit nga dita e pushimit të armiqësive.

Procedurat e shpalljes zhvillohet pranë gjykatës ku personi i zhdukur kishte vendbanimin dhe vendqëndrimin e fundit. Vendimin meritor e jep gjykatësi i vetëm dhe me atë rast zbatohen rregullat e procedurës jokontestimore.

Anulimi i martesës bëhet kur një martesë lidhet kundërshtim me dispozitat ligjore. Për shkak të rëndësisë që ka martesë shkaqet e anulimit të martesës parashihen shprehimisht me dispozita ligjore (nulla nullitas sine lege) që do të thotë nuk ka pavlefshmëri të martesës nëse shkaqet e anulimit të martesës nuk kanë qenë shprehimisht të parapara me dispozita ligjore. Si shkaqet për anulimin e martesës në të drejtën tonë na paraqiten pengesat martesore:

- Mungesa e vullnetit;
- Sëmundja psikike dhe pazotësia për të vepruar;
- Martesa ekzistuese;
- Gjinia e gjakut;
- Sekset e njëjta

Shkurorëzohet vetëm martesë e lidhur në mënyrë të vlefshme para organit kompetent në prani të dy bashkëshorteve dy dëshmitarëve dhe ofiqarit të gjendjes civile. Procedurat e zgjidhjes së martesës zhvillohet para gjykatës themelore dhe zbatohet rregullat e procedurës kontestimore. Me shkurorëzim kuptojmë:

- a) Zgjidhjen e martesës së vlefshme;
- b) Zgjidhjen e martesës vetëm gjatë jetës së përbashkët të bashkëshorteve
- c) Martesë zgjidhet vetëm me aktgjykim;
- d) Martesë zgjidhet vetëm për shkaqet e parapara në ligj dhe
- e) Martesë zgjidhet vetëm në procedurë të paraparë ligjore

E DREJTA TRASHËGIMORE

Dhurimet dhe kthimi i dhurimeve në të drejtën trashëgimore

Padenjësia nënkupton humbjen e cilësisë së trashëgimitarit ex lege. Trashëgimtari i padenjë nuk mund të trashëgojë as me ligj e as me testament.

Një trashëgimtarë konsiderohet i padenjë për të trashëguar sipas dispozitave të nenit 111 të Ligjit për trashëgimi të Kosovës nëse:

- Me dashje ka vrarë ose ka tentuar të vras trashëgimlënësin, bashkëshortin ose fëmijët dhe prindërit e tij;

- Trashëgimtari i cili ka bërë ndaj trashëgimlënësit kallëzim apo dëshmi të rreme për kryerjen e një vepre penale, për të cilën parashikohet dënimi me heqje lirie.
- Trashëgimtari që me mashtrim, kanosje e dhunë ka shtyrë trashëgimlënësit të bëj të ndryshoj ose të fuqizoj testamentin ose e ka përpiluar vetë një testament të rreme ose e ka përdorur atë për interesa të tij apo të tjerëve.
- Personi që është sjell ndaj trashëgimlënësit në mënyrë poshtëruese dhe e ka keqtrajtuar atë;
- Personi që nuk ka përmbushur detyrimin për të mbajtur apo për të ndihmuar trashëgimlënësin;
- Personi që ka penguar realizimin e vullnetit të fundit të trashëgimlënësit.

Vlerësimin e padenjësishë e një trashëgimtari për të trashëguar e bënë **gjykata**. Për këto shkaqe gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare për veç kur është fjala për shkeljen e detyrimit të mbajtjes dhe për mos dhënien e detyrimit të domosdoshëm trashëgimlënësit. Në këtë rast duhet të bëhet një kundërshtim nga pala e interesuar.

Dhurimet

Me dhurime kuptojmë çdo heqje dorë nga një e drejtë, falje e borxhit, çdo transferim i pasurisë në interes të një trashëgimtari në emrin të pjesës trashëgimore, ose për themelimin apo zgjerimin e familjes, për ushtrimin e mjeshtërisë si dhe çdo disponim tjetër pa **shpërblim**.

Nuk konsiderohen dhurime shpenzimet për mbajtje edukim, shkollim si dhe ato të bëra për kursimin e sëmundjeve apo dhurimet me vlera të vogla që i bëhen bashkëshortit.

Kthimi i dhurimeve nëse pjesa e domosdoshme nuk plotësohet me zvogëlimin e disponimit me testament, atëherë kthehen dhurimet.

Kthimi i dhurimeve bëhet duke filluar nga dhurimi i fundit dhe vazhdon me radhë tek dhurimet e më parshme. Dhurimet e bëra njëkohësisht kthehen në mënyrë proporcionale nga vlera e dhurimit. Kthimi i dhurimit mund të bëhet në afatin prej 3 vjetësh nga vdekja e trashëgimlënësit, përkatësisht nga dita që ka marrë formën e prerë vendimi për shpalljen e tij si të zhdukur ose vendimi me të cilin konfirmohet vdekja e tij.

Ky afat është prekluziv dhe palët nuk mund ta ndryshojnë me vullnetin tyre.